



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 15758 Prot

Shkodër, më 26.7.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin dhe: “Për transferimin e fondit të mbetur gjëndje në llogari jashtë thesari, për projektin “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit” nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe përdorimin e tij në funksion të programit 07220 “Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor”.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet Beci

Me Vendim Delegimi

Zv/Kryetar

Onid Bejleri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2024

“Për transferimin e fondit të mbetur gjëndje në llogari jashtë thesari, për projektin “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit” nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe përdorimin e tij në funksion të programit 07220 “Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar ; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqerisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, VKM nr. 775 datë 24.09.2010 “Për administrimin e Financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar; Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave nr 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024”; VKB nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”; si dhe kontratës së grantit me Nr. ref.: EU4M-CfP1-2022/A2, datë 23.06.2022 për të implementuar projektin “Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”, financuar nga skema e granteve ”BE Për Bashkitë” në zbatim të buxhetit të miratuar sipas VKB nr. 48, datë 27.09.2022 “Për Miratim shtesë plani në Buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr 3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë, Shkodër” i ndryshuar”, për realizimin e aktiviteteve të projektit, shkresës së dërguar nga Njësia e Mbështetjes Teknike për kthimin e fondeve teprice mbas njohjes së shpenzimeve me nr. 9094, datë 30.04.2024; shkresës së dërguar nga Njësia e Mbështetjes Teknike me nr. 13970 Prot., datë 02.07.2024, Urdhërin për kthimin e tepricës së

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e fondit të mbetur gjëndje në llogari jashtë thesari, për projektin “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit”, P09230.Q2.O1.A12, Rikonstruksioni i objektit të ish shkollës veterinarë (shtesë) nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe përdorimin e tij në funksion të programit 07220 “Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor”, sipas fishës bashkëlidhur.

Pakësim të trashëguara viti 2023

000/lekë

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Gjëndje në llog, jashtë thesari	Institucioni Likuidues
1	09230 (në llog. Jashtë thesari)	” Arsimi i mesëm i përgjithshëm”	P09230.Q2.O1.A12 Rikonstruksioni i objektit të ish shkollës veterinarë (shtesë) Projekti: “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit”,	1,593	Bashkia Shkodër
Totali				1,593	

Shtesë viti 2024

000/lekë

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Art. 602 Mallra dhe Shërbime	Institucioni Likuidues
1	07220 (Kap 6)	Shërbimet e kujdesit parësor	P07220.Q1.O1.A1 “Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor”- A.1 Mirëmbajtje e qendrave shëndetësore parësore. (shtesë)	1,593	Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike
Totali				1,593	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet Beci

Me Vendim Delegimi

Zv/Kryetar

Onid Bejleri



Zv/Kryetar

Drejtoria e përgjithshme e menaxhimit financiar

Drejtoria e Financës

Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor

Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Drejtoria e përgjithshme shërbimeve sociale dhe rinisë

Drejtoria e përgjithshme juridike, burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

Drejtoria e përgjithshme e Kulturës, Arsimit dhe Sportit

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Arsimit

Drejtoria Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1327/6 Prot

Shkodër, më 26. 7.2024

RELACION

“Për transferimin e fondit tepricë për projektin “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit” nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe përdorimin e tij në funksion të programit 07220 “Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor”.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar Këshilltarë!

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.____.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar ; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqerisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, VKM nr. 775 datë 24.09.2010 “Për administrimin e Financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar; Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave nr 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024”; VKB nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”; si dhe kontratës së grantit me Nr. ref.: EU4M-CfPI-2022/A2, datë 23.06.2022 për të implementuar projektin “Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”, financiar nga skema e granteve “BE Për Bashkitë” në zbatim të buxhetit të miratuar sipas VKB nr. 48, datë 27.09.2022 “Për Miratim shtesë plani në Buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr 3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë, Shkodër” i ndryshuar”, për realizimin e aktiviteteve të projektit, shkresës së dërguar nga Njësia e Mbështetjes Teknike për kthimin e fondeve teprice mbas njohjes së

shpenzimeve me nr. 9094, datë 30.04.2024; shkresës së dërguar nga Njësia e Mbështetjes Teknike me nr. 13970 Prot., datë 02.07.2024, Urdhërin për kthimin e tepricës së pashpenzuar për projektin me nr. 822, datë 05.06.2024, “Kthim përgjigje mbi përdorimin e fondeve tepricë”, raporti i dërguar në MF, shkresa me nr. 14117 Prot. datë 13.07.2024 për periudhën 01.01.2024 – 30.06.2024, si dhe pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë.

“Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit” titullohet projekti i përzgjedhur në kuadër të thirrjes për propozime: Skema e Grantëve BE për Bashkitë (EU4M), i financuar nga Bashkimi Europian dhe implementuar nga konsorciumi që udhëhiqet nga “Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale së Evropës-Juglindore” – NALAS, dega Shqipëri.

Ky projekt ka mundësuar financimin e përfundimit të punimeve ndërtimore pranë godinës së ish shkollës “Veterinare” me synim realizimin e projektit të Qendrës Multi-Funksionale, në të cilën tashmë ofrohen shërbime si; çerdhe&kopsht, qendër e kujdesit shëndetësor parësor, qendër komunitare “Për Familjen”, dhe shërbimet të tjera administrative të lagjes nr. 1.

Projekti ka patur ndikim në kuptimin e nevojave dhe ofrimin e shërbimeve për individët dhe grupet vulnerabël. Projekti ka patur një numër total prej 1000 përfituesish që përfitojnë nga shërbimet e çerdheve dhe kopshteve, aktiviteteve/trajnimeve të përfshirjes sociale, qendrës komunitare (kujdesi ditor për të moshuarit, hapësira rinore) dhe 4940 përfitues të qendra e kujdesit parësor shëndetësor.

Me njohjen e raportit financiar ka pasur një tepricë gjëndje, për të cilën donatori me shkresën nr. 13970 Prot. datë 02.07.2024 “Kthim përgjigje mbi përdorimin e fondeve tepricë”, është shprehur se nëse në llogarinë e dedikuar për projektin ka akoma fonde të mbetura, menaxhimi dhe përdorimi i tyre është çështje e brendshme e Bashkisë Shkodër.

Me qëllim përmirësimit e ofrimit të kushteve të shërbimit shëndetësor parësor, është evidentuar nevoja për shtim të fondit në dispozicion. Konkretisht do të ndërhyhet në qendrën shëndetësore Zues dhe Golem, pjesë e njësisë administrative Rrethina, duke iu shtuar fondit të Bashkisë për vitin 2024.

Në këto kushte, është i nevojshëm transferimi i fondit gjëndje në llogari jashtë thesari për projektin “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit” nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe përdorimi i tij në funksion të programit 07220 “Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor”, sipas fishës bashkëlidhur.

Pakësim të trashëguara viti 2023

000/lekë

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Gjendje në llog, jashtë thesari	Institucioni Likuidues
1	09230 (në llog. Jashtë thesari)	"Arsimi i mesëm i përgjithshëm"	P09230.Q2.O1.A12 Rikonstruksioni i objektit të ish-shkollës veterinare (shitesë) Projekti: "Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit".	1,593	Bashkia Shkodër
Totali				1,593	

Shtesë viti 2024

000/lekë

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Art. 602 Mallra dhe Shërbime	Institucioni Likuidues
1	07220 (Kap 6)	Shërbimet e kujdesit parësor	P07220.Q1.O1.A1 "Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor"- A.1 Mirëmbajtje e qendrave shëndetësore parësore. (shitesë)	1,593	Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike
Totali				1,593	

Me Vendim Delegimi
24/Kryetar
Onid Bejleri

KRYETAR

Benet Beci

Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve Sociale dhe Rinisë

Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës, Arsimit dhe Sportit

Drejtoria e Arsimit

Nr. 01	P07220.Q1.O1.A1 Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor (shitesë)	Funksioni 7: SHËNDETËSIA N/Funksioni 072: Shërbimet e kujdesit parësor Programi 07220: Shërbimet e kujdesit parësor
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik pranë Bashkisë së Shkodrës, ndër detyrat funksionale ka përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat në nevojë, ku pjesë e kësaj është vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, rristurimi i tyre, planifikimi dhe projektimi i ndërhyrjeve, me synim që të krijohen kushtet e përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Në këtë kuadër, Bashkia e Shkodrës ka përditësuar sistemin databazë për regjistrimin e çdo qendre shëndetësore në territorin e saj me të gjitha të dhënat specifike të tyre: nevojat, shërbimet, stafin, zonën që mbulon, problematikat, funksionalitetin e qendrave shëndetësore parësore etj.</p>		
<p>Është vazhduar me projektimin dhe rikonstrukcionin e disa objekteve, të braktisura prej vitesh, por në pronësi të Bashkisë Shkodër, duke krijuar 5 qendra të reja shëndetësore; si në njësinë administrative Rrethina (Shtoj i Vjetër), në qendrën Komunitare Multifunksionale "Ngjyrat" në lagjen nr 1, në ish godinën e U.K Shkodër, në lagjen Nr.3 dhe një qendër të re shëndetësore për lagjen Nr.1, në ambjentet e ish shkollës veterinare. Janë rikonstruktuar qendra shëndetësore Trush, Bërdicë e Madhe, Velipojë dhe qendra shëndetësore Zogaj.</p>		
<p>Ka përfunduar ndërhyrja për vendosjen në funksion dhe mirëmbajtjen e ambulancave Mali Kolaj dhe Rrjoll, Njësia Administrative Velipojë, si dhe janë rehabilituar ambjentet e ish shkollës së Samrishit për ndërtimin e një qendre shëndetësore për zonën përreth.</p>		
<p>Nga vlerësimi dhe analiza e gjendjes aktuale të infrastrukturës ekzistuese të qendrave shëndetësore parësore dhe dëgjesa publike të realizuara në kuadër të PBA 2024-2026 konstatohet nevoja për planifikimin e disa ndërhyrjeve të nevojshme me qëllim sigurimin e kushteve të nevojshme të ofrimit të shërbimit shëndetësor parësor në disa ambulanca të qytetit dhe njësitë administrative Rrethina, Postrisë, Rrethina etj.</p>		
<p>Konkretisht do të ndërhyhet në qendrën shëndetësore Zues dhe Golem, pjesë e njësisë administrative Rrethina, duke iu shtuar fondit të Bashkisë për vitin 2024.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojë dhe analizojë gjendjen aktuale të infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor dhe të planifikojë ndërhyrjet e nevojshme. • Të vlerësojë rastet emergjente dhe të priorizojë ndërhyrjet që gjykohen emergjente për mungesë kushtesh. • Të promovojë zgjerimin e mëtëjshëm të shërbimit shëndetësor parësor me qëllim mbulimin sa më të gjerë të popullsisë dhe territorit. • Të vlerësojë dhe promovojë aksesin e barabartë për shërbimet shëndetësore në të gjithë segmentet apo grupet e popullatës. • Të identifikojë partnerë dhe të krijojë aleanca të qëndrueshme ndërmjet institucioneve publike, donatorëve dhe OJF-ve. • Të nxisë dhe mbështesë qasjen multi- sektoriale në zhvillimin e shëndetit komunitar, bashkë me sektorin social, arsimor, sportiv, etj. • Të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor për të organizuar aktivitetet e saj, si me OSHKSHSH, NJVKSHSH, DRFSDKSH. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Përditësimi bazë i të dhënave për qendrat shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje. ▪ Projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor. ▪ Mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar. ▪ Mirëmbajtje e qendrave shëndetësore parësore në territor në varësi të nevojave të konstatuara. • Vlerësimi dhe monitorimi periodik i ambjenteve të qendrave shëndetësore të shërbimit shëndetësor parësor në gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës me synim prioritarizimin e ndërhyrjeve. ▪ Bashkëpunimi i afërt me OJF dhe biznesin privat në projekte që synojnë përmirësimin e shëndetit komunitar dhe fuqizimin e sistemit shëndetësor në përgjithësi. 		
b) Rezultatet që prisni		
<ul style="list-style-type: none"> o Databazë e përditësuar me informacion mbi qendrat shëndetësore të shërbimit parësor në territorin e Bashkisë së Shkodrës. o Forcimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor në territorin e Bashkisë Shkodër. o Zgjerimi i rrjetit të shërbimit shëndetësor parësor në objekte ekzistuese të Bashkisë së Shkodrës. 		

o Rritje e aksesit të barabartë për shërbimet shëndetësore për të gjithë grupet e popullatës.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Komuniteti,			OJF, OSHKSHSH, NJVKSH, DRFSDKSH			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Mirëmbajtje e qendrave shëndetësore parësore	1,593			1,593	
	Shuma	1,593			1,593	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar – Dhjetor 2024		Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike Stafi i drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Drejtorisë Juridike, Sektori i aseteve Institucioni Likujdues: Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike				